

## **TRANSPLANTET LIGJORE TË NEVOJSHME PËR PROCESIN E INTEGRIMIT DHE KUSHTET E BRENDSHME INSTITUCIONALE E ADMINISTRATIVE PËR SUKSESIN E TYRE**

Eralda (METHASANI) ÇANI\*

### **1. Hyrje**

Ky punim bazohet në premisën se nëse Shqipëria dëshiron të arrijë suksese në reformat administrative në rrugën drejt BE-së do duhet më së pari të ketë shtysa të brendshme dhe po ashtu kapacitete të brendshme të mjaftueshme. Mungesa e tyre minon procesin e suksesshëm të integritimit.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian përbën një sfidë me rëndësi të madhe për historinë, jo vetëm politike, të Republikës së Shqipërisë. Ai është një nga objektivat madhore që synon integrimin e plotë në familjen evropiane, bashkëpunimin e ngushtë, paqen dhe stabilitetin në vend, rajon e më gjerë, zhvillimin dhe modernizimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë, për një të ardhme më të mirë e më të sigurt. Entuziazmi i popullsisë shqiptare është mjaft i madh dhe mbështetja po ashtu, por sigurisht që entuziazmi nuk mjafton. Ai kushtëzohet me realizimin dhe zbatimin me sukses të një sërë reformash në vend. Përmes tyre duhet të hidhen baza të qëndrueshme e të domosdoshme për të bërë transformime dhe ndryshime kushtetuese, ligjore e institucionale, dhe politikash në të tre pushtetet, të cilat do të mundësonin respektimin sa më mirë të parimeve të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, mëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë, përafrimin e legjislacionit kombëtar me standardet e kërkuara ndërkombëtare e evropiane. Të gjitha këto kërkojnë profesionalizëm, kualifikim e angazhim serioz në të gjitha nivelet e qeverisjes së vendit dhe bashkëpunimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm me institucionet e Bashkimit Evropian, mbi bazën e një programi të qartë e të përcaktuar mirë.

### **2. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Evropian**

Historia e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike zyrtare me Bashkimin Evropian (Komunitetin Evropian) fillon në pranverën e vitit 1991.<sup>1</sup> Një vit më pas, më 11 maj 1992, midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE) u nënshkrua Marrëveshja mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin, e para e këtij lloji për të gjithë rajonin e Ballkanit. Po në vitin 1992 u nënshkrua edhe Deklarata e Përbashkët mbi Dialogun Politik.<sup>2</sup> Që në vitin 1992, në kuadër të Marrëveshjes Mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin, Shqipëria ka përfituar nga BE mbështetje të konsiderueshme financiare, fillimisht nga programi PHARE. Synimi kryesor i tyre ka qenë zhvillimi dhe realizimi i një sërë reformave të rëndësishme, si

---

\* Dr. Eralda (Methasani) Çani, Titullare e Lëndës 'E Drejtë Administrative', Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

<sup>1</sup> Për një paraqitje të plotë të historikut të marrëdhënieve të Shqipërisë me BE-së shih ndër të tjera: <[http://ec.europa.eu/enlargement/albania/key\\_events\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/albania/key_events_en.htm)>.

<sup>2</sup> Hyrë në fuqi më 1 dhjetor të vitit 1992.

parakushte për integrimin në BE. Zhvillimet e brendshme,<sup>3</sup> por më shumë ato rajonale çuan në miratimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit në vitin 1999.<sup>4</sup> Në vitin 2003 me samitin e Selanikut u konfirmua përfundimisht perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor e cila do të vlerësohej në bazë të një axhende dhe vlerësimi individual të shteteve të Ballkanit Perëndimor.<sup>5</sup> Në qershor të vitit 2004, Këshilli miratoi Partneritetin e Parë Evropian me Shqipërinë ndërkohë që Progres-Raportet e hartuara për çdo vit nga viti 2005 deri më tani kanë evidentuar arritjet dhe problemet.<sup>6</sup>

Në janar të vitit 2003 u hapën zyrtarisht negociatat për përfundimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) mes BE dhe Shqipërisë dhe në qershor të vitit 2006 u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asociimit si dhe Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar, në Luksemburg, në Këshillin e Marrëdhënieve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Më 1 dhjetor 2006 hyri në fuqi Marrëveshja e Ndërmjetme mes BE-së dhe Shqipërisë e cila përmban dispozitat e MSA-së mbi tregtinë<sup>7</sup>. Pas ratifikimeve të nevojshme, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2009.<sup>8</sup> Në vijim, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë miratoi Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.<sup>9</sup> Kështu, marrëdhënia e Shqipërisë me BE u vendos në kontekstin e një marrëdhënie kontraktuale me të drejta dhe detyrime të rëndësishme për të dy palët, e cila u zbërthe më tej nga qeveria Shqiptare.

Qëllimi i marrëveshjes është zbatimi i reformave dhe arritja e standardeve për një qasje graduale politike, ekonomike e sociale të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përbëhet nga katër kolona themelore:

- 1) Dialogu politik që synon krijimin e lidhjeve të ngushta dhe të qëndrueshme mes BE dhe Shqipërisë si dhe bashkëpunimin rajonal;

<sup>3</sup> Këtu i referohem kryesisht zgjedhjeve të kontestuara të vitit 1996 si dhe problemeve madhore që pasuan krizën e piramidave të vitit 1997 në vend.

<sup>4</sup> Këshilli Evropian në vitin 1997 vendosi të ashtuquajturën “përjasje rajonale” (Regional approach) ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në themel qëndronte ideja e “kushtëzimit politik dhe ekonomik” të marrëdhënieve dypalëshe të BE-së me të gjitha shtetet e këtij rajoni. Më pas, Bashkimi Evropian do t’i saktësonte e plotësonte më tej kushtëzimet e mësipërme me respektimin e parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mbrojtjen e minoriteteve, bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut, me synimin prioritar stabilitetin politik, ekonomik dhe social të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke miratuar në maj të vitit 1999 iniciativën e veçantë për 5 vendet e këtij rajoni, të quajtur Procesi i Stabilizim Asociimit, përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë.

<sup>5</sup> Axhenda u bazua në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe vlerësimi individual për çdo shtet do të bëhej në përmbushje të kriterëve për anëtarësim, të përcaktuara nga Këshilli Evropian i Kopenhagenit në dhjetor të vitit 1993.

<sup>6</sup> Instrumenti i Partneritetit Evropian identifikon në vazhdimësi prioritetet dhe objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm, me qëllim që të bëhen reformat dhe të merren masat e nevojshme me karakter politik, ekonomik, institucional dhe financiar, që kërkohet të realizohen në kuadër të integritimit evropian.

<sup>7</sup> Përjashtimi synoi marrjen e masave të duhura për të përmbushur standardet e kërkuara në tregti. Shqipëria përfitoi veçanërisht nga heqja apo ulja progresive e detyrimeve doganore dhe si dhe kufizimeve sasiore në tregti me vendet e BE.

<sup>8</sup> Miratuar në Republikën e Shqipërisë me Ligjin Nr 9590, datë 27.07.2006 “Për Ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të Tyre Anëtare”Shtojca II(B)”.

<sup>9</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 557, dt. 5.09.2007.

- 2) Krijimi i një Zone të Tregtisë së Lirë mes palëve brenda një periudhe 10 vjeçare që synon krijimin e një ekonomie funksionale tregu në Shqipëri;
- 3) Liritë komunitare; dhe
- 4) Forcimi i bashkëpunimit në disa fusha parësore, kryesisht në fushën e drejtësisë dhe çështjet e brendshme.<sup>10</sup>

Më 28 prill të vitit 2009 Shqipëria paraqiti zyrtarisht në Këshillin Evropian kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë (GAERC) i BE-së i kërkoi Komisionit Evropian të përgatisë opinionin për Shqipërinë. Tashmë pyetëtori i plotësuar nga administrata shqiptare i është dorëzuar në prill 2010 Komisionit Evropian. Pritet që procesi të vijojë me dhënien e përgjigjes për statusin e vendit kandidat.

E gjithë kjo rrugë pothuaj dy dekadëshe ka qenë e përshkruar pa dyshim edhe nga reforma të thella institucionale dhe ligjore të cilat gjithnjë e më shumë kërkonin të afronin legjislacionin shqiptar me legjislacionin e BE-së. Në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit parashikohen përafrime të qarta në fushën e legjislativit, ndërkohë që në lidhje me institucionet kërkohet forcim dhe qëndrueshmëri e tyre. Reformat legjislativë dhe ato institucionale janë kusht i nevojshëm për realizimin e njëra-tjetrës. Pa institucione profesionale, të qëndrueshme e të përafruara, transplantet ligjore të nevojshme për integrim në BE janë pothuaj të pamundura. Pa dyshim, nga ana tjetër, konsideruar që institucionet janë krijuar ligjore, qasja e tyre me rregulla themelore demokratike apo reflektimi i rregullimeve që tashmë gjenden në BE në lidhje me to, nuk është i mundur. Duke kushtëzuar njëra-tjetrën kështu duket sikur gjendemi përballë një rrethi të mbyllur i cili e bën të pamundur reformën të realizohet. Çështjet shtrohen për zgjidhje në vijueshmëri të pandarë të njëra-tjetrës, por po ashtu në mënyrë të pandarë edhe ndryshimet ndodhin dora-dorës. Mjaft i rëndësishëm në mirëfunksionimin e këtij zinxhiri është vullneti politik. Së pari, reforma të tilla duhet të mishërohen në programet politike të shumicës parlamentare që formon qeverinë, dhe së dyti, duhet që aktorët themelorë propozues dhe miratues të kuadrit ligjor në vend, si Këshilli i Ministrave, Kuvendi e pse jo edhe vetë qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për ngarkesën që bie mbi ta dhe nevojën për përkushtim në procesin e përafrimit ligjor e reformimit institucional si kushte të padiskutueshme në procesin e integritit.

### **3. Reformat administrative dhe ato ligjore të nevojshme për anëtarësimin**

#### *3.1 Reformat administrative*

Në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Shqipëria duhet që në mënyrë progresive të adoptojë reforma materiale dhe procedurale të përcaktuara qartë apo të nënkuptuara. Kështu, në përputhje me një detyrim të parashikuar qartë në MSA, Shqipëria duhet të krijojë organe administrative që menaxhojnë më mirë interesin publik, janë eficientë dhe të përgjegjshme, si dhe të hapura për këdo dhe profesionale. Shprehimisht N. 111 i MSA parashikon zhvillimin e ‘një administrate publike eficientë dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të shtetit të së drejtës,

<sup>10</sup> Edhe për realizimin e qëllimeve të këtyre shtyllave themelore BE ka ofruar dhe ofron ndihma të konsiderueshme financiare përmes programeve të ndryshme si CARDS apo ai IPA (që nga viti 2007).

funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë’ si dhe ‘ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në administratën publike dhe qeverisjes elektronike.’ Edhe pse neni 111 është i vetmi që i referohet shprehimisht që në titull nevojës për përshtatje të tilla që të krijojnë një administratë publike mjaftueshmërisht të përshtatshme për anëtarësim, MSA në tërësinë e saj parashikon disa detyrime për Shqipërinë në lidhje me administratën. Kështu, Neni 1 i MSA kërkon ‘forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës’ si dhe ‘stabilitet politik, ekonomik e institucional në Shqipëri.’ Po ashtu, Neni 2 i MSA gjithashtu kërkon respektim të ‘parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut’, ‘parimeve të së drejtës ndërkombëtare’, apo edhe ‘të shtetit të së drejtës.’ Të tilla parashikime janë të përgjithshme dhe një analizë në detaje e legjislacionit tregon që të tilla kërkesa nevojiten të adresohen edhe më mirë.

Po t’i referohemi kuadrit ligjor në fuqi për rregullimin e stabilitetit, efijencës apo profesionalizmit në administratën publike, mund të themi që ai ka mangësi si ligjore ashtu edhe në zbatim. Ndërsa mangësitë në zbatim janë të adresueshme me një kërkesë të fortë llogarie, mangësitë ligjore kërkojnë amendamente ligjore. Legjislacioni vendas i cili përfshin në nivelin e parimeve kërkesën për efijencë, referuar në kuptimin e pjesëmarrjes maksimale të publikut në vendimmarrje,<sup>11</sup> apo të profesionalizmit dhe stabilitetit të punonjësve në administratën publike, referuar pothuaj vetëm atyre që quhen nëpunës civilë sipas Ligjit 8459 (1999) (nëpunësit civilë në administratën publike numërohen në nivelin e 1/10 e numrit total të punonjësve),<sup>12</sup> sepse punonjësit e tjerë që nuk janë subjekte të këtij ligji nuk gëzojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie dhe mbrojtjeje ligjore,<sup>13</sup> duket që në përgjithësi ka referenca ligjore në çështjet që përmenden në nenet e sipërcituara të MSA-së. Megjithatë, këto referime janë të pamjaftueshme për sa kohë që efijenca është në nivel parimi dhe nuk zërthehet mjaftueshëm në legjislacion, apo që marrëdhëniet e qëndrueshme të punës në administratën publike janë të tilla, të paktën *de jure*, vetëm për shërbimin civil dhe jo për të gjithë administratën publike. Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZH)<sup>14</sup> janë miratuar objektiva të posaçme për Administratën Publike,<sup>15</sup> si përmirësimi i procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe zgjerimi i fushës së veprimit të këtij legjislacioni;<sup>16</sup> krijimi dhe zbatimi i skemave të shpërblimit për nëpunësit publikë me qëllim diferencimin e nëpunësit publik mbështetur në kualifikim; përmirësimi i sistemit të menaxhimit të

<sup>11</sup> Shih N. 16 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

<sup>12</sup> Raport shih: <<http://www.itap.gov.al/new%20web/PDF%20ITAP/RAPORT%202009%20final-%20ENGLISH.pdf>>.

<sup>13</sup> Për më gjerë mbi këtë çështje shih: (Methasani) Çani E., *Marrëdhëniet e Punës në Administratën Publike: Analizë e Legjislacionit Shqiptar*, Qendra AKSES, Shqipëri, Shtëpia Botuese albPaper, Dhjetor 2009.

<sup>14</sup> Botuar në Fletore Zyrtare nr. 156, datë 20.11.2009, fq. 6083.

<sup>15</sup> Kapitulli II i Strategjisë. Shih edhe <<http://www.pad.gov.al/APreforma.pdf>>.

<sup>16</sup> Shih Pika 2.1 e Kapitullit II të Strategjisë.

performancës. Edhe pse ka një strategji të miratuar në vitin 2009 për reformën në administratën publike që adreson edhe këto çështje, ende ligjërisht ato mbeten të adresohen.<sup>17</sup>

Në një vështrim të përgjithshëm, në këndvështrimin edhe të Komisionit Evropian, administrata publike shqiptare pavarësisht reformave që ka kryer ka edhe një sërë detyrimesh të paadresuara. Progres-raportet ndër vite kanë adresuar këtë çështje duke evidentuar edhe problemet, si ato të raportit të vitit 2009, ku ndër të tjera përfshihen:

- administrata publike vazhdon të stabilizohet, por mungesa e transparencës dhe përgjegjshmërisë në emërimet po rrezikon pavarësinë e saj;
- emërimet dhe zëvendësimet me karakter politik të nëpunësve të administratës publike kanë vazhduar, ndonëse në një shkallë më të vogël;
- zëvendësimet e shpeshta të nëpunësve civilë po dëmtojnë pavarësinë e shërbimit civil dhe po rrisin rastet e korrupsionit të zyrtarëve publikë;
- nevojitet të forcohet më tej qeverisja e sektorit publik, duke rritur pavarësinë e administratës publike, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian: shpesh konkurrimi është jomeritokratik dhe kontratat provizore;
- mungesa e transparencës dhe përgjegjshmërisë në emërimet mbetet një prioritet kyç i Partneritetit Evropian që duhet të adresohet.<sup>18</sup>

Duhet thënë qartë që ky proces kërkon ‘transplante (përshtatje)’ ligjore që synojnë reformim institucional me qëllim jo vetëm forcimin e administratës publike, por edhe përshtatjen e saj me qëllim realizimin sa më me efikasitet të gjitha përafrimeve dhe reformave legislative që kërkohen. Organe të tilla, të cilat vishen me kompetenca për realizimin e këtij procesi janë:

- A) Tërësia e institucioneve drejtpërdrejt të angazhuara në procesin e integritetit, e këtu mund të veçohet Kuvendi (Parlamenti) i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Integritetit.
- B) Të gjitha institucionet publike të cilat kanë për detyrë përafrimet materiale e procedurale në fusha të posaçme administrative: këtu referenca bëhet tek të gjitha ato organe që janë të veshura me realizimin e detyrave konkrete sipas MSA, si për shembull detyrimi i organeve tatimore për ristrukturim me synim mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal,<sup>19</sup> apo i atyre doganore për të mos aplikuar detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e

<sup>17</sup> Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1017, dt. 18.9.2009, ‘Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të reformës në administratën publike’.

<sup>18</sup> COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES: *ALBANIA 2009 PROGRESS REPORT accompanying the COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL Enlargement Strategy and Main Challenges 2009-2010*, Brussels, 14.10.2009, {COM}, SEC(2009) 1337/3 Shih <[http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu\\_albania/2009\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2009_progress_report_en.pdf)>.

<sup>19</sup> Neni 98 i MSA.

kanë origjinën në Komunitet me disa përjashtime të renditura në MSA,<sup>20</sup> apo detyrimin e cilitdo organ që të mos aplikojë kufizime sasiore apo masa me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Shqipëri apo edhe Komunitet përkatësisht.<sup>21</sup>

Në lidhje me të parën janë krijuar tashmë disa institucione të posaçme si p.sh:

- Ministria e Integritimit Evropian e krijuar në tetor të vitit 2001 (fillimisht si Ministri i Shtetit për Integrim shndërruar në Ministri në vitin 2005) e cila ka rol qendror në procesin e integritimit si dhe posaçërisht të përafrimit të legjislacionit shqiptar në *acqui* të BE-së;<sup>22</sup>
- Komiteti Ndërmnistror për Integrimin Evropian, i krijuar në vitin 2009 për të drejtuar dhe miratuar politikat e përgjithshme e të strategjisë për integrimin e Shqipërisë në BE.<sup>23</sup>
- Komiteti i Koordinimit Ndërmnistror për Integrimin Evropian përgjegjës për monitorimin dhe bashkërendimin e detyrimeve të MSA dhe të dokumenteve strategjike për integrimin evropian, në zbatim të vendimeve dhe udhëzimeve të Komitetit Ndërmnistror të Integritimit Evropian.<sup>24</sup>
- Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit si dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit.
- Në Kuvend është krijuar një Komision i Përhershëm Parlamentar për Integrimin Evropian, detyra themelore e të cilit është të monitorojë procesin e integritimit, të vlerësojë përputhshmërinë e projektligjeve me *acqui communautaire* dhe të kontrollojë veprimtarinë e Ministrisë së Integritimit dhe të ministrive të tjera në lidhje me integrimin. Madje, sipas Nenit 68/2 të Rregullores së Kuvendit, çdo projektligj duhet të shoqërohet me një relacion, në të cilin duhet evidentuar përputhshmëria e tij me legjislacionin e BE-së proces të cilin e monitoron ky Komision.

Tërësia e institucioneve të krijuara posaçërisht për të realizuar, lehtësuar apo monitoruar procesin e integritimit evropian të vendit është e vendosur kështu në nivelin qendror, ekzekutiv si dhe atë legjislativ. Këto organe nuk janë të vetmet, edhe pse roli i tyre është kyç në procesin e integritimit qoftë për hartimin e politikave të nevojshme, për koordinimin e duhur si dhe monitorimin e zbatimit të detyrimeve. Ajo që

<sup>20</sup> Neni 19 i MSA.

<sup>21</sup> Neni 26 i MSA.

<sup>22</sup> VKM nr. 580, dt. 10.09.2004 'Për krijimin dhe fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integritimit'.

<sup>23</sup> Miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 46, dt. 1.04.2009. Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga ministrat dhe funksionarët më të lartë të institucioneve qendrore. Mbledhjet e tij janë periodike dy herë në muaj.

<sup>24</sup> Krijuar në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 46, datë 1.04.2009. Kryesohet nga Ministri i Integritimit, përbëhet nga përfaqësues të ministrive në nivel zëvendësministri dhe zbaton vendimet dhe udhëzimet e Komitetit Ndërmnistror të Integritimit Evropian.

mund të thuhet gjithsesi është që çështje të tilla të referuara në MSA si shteti i së drejtës, institucione demokratike e me radhë, përfshijnë pa dyshim më shumë se sa vetëm ekzekutivi apo legjislativi, dhe më shumë se sa pushteti qendror. Organe të tilla si ato të pushtetit vendor duhet të reflektojnë gjithashtu realizimin e detyrimeve në rrugën e procesit të integritit, dhe koordinimi edhe me to është një nevojë që duhet adresuar edhe në këndvështrimin institucional. Kështu, mendoj se këto organe mund të organizohen edhe për të reflektuar tërësinë e organeve të pavarura apo edhe ato të pushtetit vendor si dhe të gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë. Nëse institucionet shtetërore nuk angazhohen në një hap në procesin e integritit, ky proces do të ishte i penguar. Vetë specifika e organizimit të administratës publike në vendin tonë është e tillë që përfshin organe varësia e të cilëve nga njëra-tjetra nuk ekziston, gjë që do të thotë se nëse marrëdhëniet nuk vendosen në kontekstin e duhur ligjor ato nuk do të mundën dot të përkthehen drejtpërdrejt si një marrëdhënie institucionale mes organeve të ekzekutivit qendror e organeve të tjera dhe kështu do të mund të shfaqen potencialisht probleme në realizimin eficient të kërkesave që ka vetë procesi i integritit.

Në lidhje me përafrimin e posaçëm, domethënë në fusha të posaçme, duhet thënë së pari se në çdo ministri ka persona kyç të emëruar si pikëlidhje mes procesit normativ që kryhet në Ministri dhe përafrimit të nevojshëm me *acquis* të BE-së. Po ashtu, çdo institucion në referim të MSA-së, në vijueshmëri kërkohet të ndërmarrë masat e duhura me qëllim përshtatjet e nevojshme institucionale. Mund të thuhet që reforma të tilla të rëndësishme si ajo e qeverisjes elektronike, përfshirë këtu edhe një sërë ligjesh të miratuara si p.sh. ai mbi nënshkrimin elektronik, apo edhe ato të krijimit të institucioneve të përqendruara si Qendra Kombëtare e Licencimit apo e Regjistrimit të Bizneseve për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve apo krijimi i Komisionerit për Antidiskriminim janë reforma institucionale që reflektojnë kërkesat e MSA-së për procesin e integritit. Këto reforma të përmendura shihen edhe në kuadër të *përmirësimit të luftës kundër korrupsionit*, e cila synon në ndërmarrjen e reformave sektoriale në lidhje me çështje të tilla si klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia pushteti vendor etj).

### 3.2 Reformat ligjore

Një çështje e rëndësishme që lidhet me funksionimin e posaçëm të administratës është ajo që ka të bëjë me aspektet ligjore. Neni 70 i MSA-së kërkon realizimin e procesit të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së, e shprehimisht që:

Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Sipas këtij neni përafrimi i legjislacionit vendoset nën detyrimin e sigurimit të shkuarjes gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të Komunitetit, duke konsideruar po aq të rëndësishëm imponimin siç duhet

të këtij legjislacioni. Paragrafi i dytë i këtij neni thekson se përafrimi i legjislacionit fillon me nënshkrimin e MSA në qershor 2006 duke u shtrirë gradualisht në të tërë elementet e *acquis* së Komunitetit që përmenden në MSA deri në vitin 2016,<sup>25</sup> e ndarë kjo në dy faza, 2006 – 2011 dhe 2011 – 2016. Synimi kryesor i përafrimit të legjislacionit gjatë gjithë periudhës 10 vjeçare është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional, i cili do t'i krijonte mundësinë tregut shqiptar të integrohej gradualisht në tregun e brendshëm evropian. Paragrafi i tretë i nenit 70 të MSA thekson se gjatë periudhës së parë, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësore të *acquis* së Tregut të Brendshëm ashtu si edhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, te drejtat mbi pronësinë intelektuale, prokurimi publik, shërbimet financiare, mbrojtja e konsumatorit, ligji për kompanitë tregtare, e tjerë. Në fazën e dytë, Shqipëria do të përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*.

Para se të vijojmë me analizën e rrugës që ndjek ky proces përafrimi, duhet përmendur që përafrimi i legjislacionit nuk ka filluar me MSA-në, pasi masat për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së janë marrë edhe më parë nënshkrimit të MSA. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 584/2003, në pikën 25 të tij parashikon shprehimisht detyrimin që të gjitha projekt-aktet me karakter normativ që i paraqiten Këshillit të Ministrave nga ministrinë e linjës duhet të kenë opinionin e Ministrisë të Shtetit për Integrim që jep vlerësimin lidhur me nevojën dhe shkallën e përafrimit me legjislacionin komunitar.<sup>26</sup> Një vit më pas, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 580/2004 'Për krijimin dhe fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integrit' përsërit qartë që përafrimi i legjislacionit kombëtar me *acquis* e BE përbën një nga detyrat prioritare të kësaj Ministrisë. Në vitin 2006 i janë bërë ndryshime të tjera Rregullores së Këshillit të Ministrave miratuar me VKM nr. 584/2003,<sup>27</sup> të cilat saktësojnë më tej detyrimin e ministrive të linjës për të paraqitur së bashku me aktin e propozuar edhe një Deklaratë dhe një Tabelë Pajtueshmërie, të cilat ja dërgojnë për mendim Ministrisë së Integrit. Madje duhet thënë që në këtë ministri funksionon një drejtori e veçantë që merret me përkthimin e legjislacionit të BE si dhe hartimin e tabelave të përputhshmërisë. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584 i miratuar në vitin 2003 është amenduar edhe në vitin 2009, ndryshim sipas të cilit kërkohet që në tekstin e projekt-aktit normativ që synon përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* të shënohet numri CELEX, data e miratimit dhe titulli i plotë i instrumentit ligjor të *acquis communautaire* me të cilën është përafuar projekt-akti i propozuar. Një kërkesë e tillë domosdoshmërisht sjell edhe rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të administratës publike përkatësisht në fushat e *acquis* të BE-së që lidhen me fushën e veprimtarisë së institucionit ku ata janë të angazhuar. Pra, jo vetëm që legjislacioni orientohet të jetë në qasje të qartë me legjislacionin e BE-së por edhe kjo kërkesë kërkon paraprakisht kryerjen e një pune kërkuese, analitike, e krahasuese me qëllim përshtatjet e duhura ligjore. Kjo e fundit nënkupton rritje të kapacitetit profesional, edhe pse duhet thënë që kjo kërkesë nuk nënkupton një lidhje të domosdoshme dhe të padiskutueshme mes situatës dhe pasojës analitike. Ka një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në formimin e këtij kapaciteti profesional.

<sup>25</sup> Shih N. 6 të MSA.

<sup>26</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 28.8.2003 'Për miratimin e rregullores së KM', hartuar në bazë të Ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003 'Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave'.

<sup>27</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 201, dt. 29.03.2006.

Detyrime të ngjashme si ai i parashikuar në vendimin e sipërpërmendur të Këshillit të Ministrave, parashikohen në rastin e projektligjeve edhe për Kuvendin e Shqipërisë. Në pikën dy të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit,<sup>28</sup> theksohet se të gjithë projektligjet duhet të jenë të shoqëruara me një relacion, përmes të cilit duhet të argumentohet harmonizimi i tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Më tej, projektligji i propozuar i kalon Komisionit për Integrim Evropian, si komisioni përgjegjës që jep mendim përfundimtar për përputhshmërinë e tij me *acquis* të BE-së,<sup>29</sup> para diskutimit të tij në seancën plenare të Kuvendit.

Duke konsideruar që të tilla procese janë të nevojshme dhe pra transplantet e duhura për të ecur drejt rrugës së integritimit, duket sikur ky lloj detyrimi për të miratuar projekt-ligje që të jenë në përputhje me *acquis* të BE-së është një detyrim që nënkupton njëfarë ‘de-parlamentarizimi’, por pse jo edhe një farë ‘de-qeverisjeje’ në vend, një prej argumenteve të adresuara edhe prej të ashtuquajturës ‘*inciativa Barroso*’ në vitin 2006.<sup>30</sup> Duket sikur balanca parlament-qeveri anon shumë nga puna e qeverisë, që do të thotë që puna kontrolluese e parlamentet edhe de fakto është e vogël dhe pak e mundur të ndodhë. Megjithatë në referim të shifrave të vendimmarrjes parlamentare kjo balancë dukshëm anon nga qeveria: nga 91 deri në 99 përqind e ligjeve të miratuara në Kuvend përgjatë viteve 1998 deri në vitin 2008 janë propozime të Këshillit të Ministrave.<sup>31</sup> Pra, edhe nëse perceptohet si deficit i mundshëm për parlamentin, nuk duhet harruar që ky i ashtuquajtur ‘deficit’ tashmë ekziston si një marrëdhënie normale mes tyre. Më tej, procesi i reformimit të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë është një proces që prej vitit 1991 ka qenë i orientuar me pikë referimi vende të demokracive të konsoliduara, kryesisht të Evropës perëndimore. Një sërë ligjesh janë miratuar në reflektim të legjislacioneve të vendeve të tilla si Gjermania, Italia, Franca, etj, dhe sidomos një sërë ligjesh që adresojnë organizimin dhe funksionim e administratës publike janë në reflektim të rekomandimeve apo marrëveshjeve të organizmave të tillë rajonale evropiane si p.sh. Këshilli i Evropës. Pra, procesi i ligjbërës në vend prej vitesh orientohet tashmë jo si një vullnet që lind së brendshmi me një shkallë të lartë, por si një reflektim i rregullimeve të shteteve të avancuara demokratike. Kështu që edhe argumenti i de-parlamentarizimit, pavarësisht nuancave që ka, është mjaft i zbehtë në vend. Nëse ky argument do të qëndronte fort kjo do të ishte tregues i një niveli të ulët të kapaciteteve profesionale të vërteta, por thjesht i bindjes në shkallë të lartë ndaj procesit të integritimit (‘me sy mbyllur’, konsideruar *in extremis* këtë situatë).

### 3.3 Aspekte materiale dhe procedurale

Një nga shqetësimet që mund të ngrihet në lidhje me transplantet e nevojshme ligjore është edhe ai që ka të bëjë me aspektet procedural dhe material. Duket sikur, nisur edhe nga argumenti i përmendur më sipër mbi ‘de-parlamentarizimin’ apo ‘de-qeverisjeje’, procesi përfshin më shumë aspekte procedurale

<sup>28</sup> Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 166, datë 16.12.2004.

<sup>29</sup> Shih N. 70/1 i Rregullores së Kuvendit.

<sup>30</sup> Komisioni (BE), ‘*A citizens’ agenda – delivering results for europe*’ (Komunikim) COM(2006), 10 maj 2006.

<sup>31</sup> Shih për një analizë më të gjerë të kësaj çështje të marrëdhënies mes qeverisë e parlamentit Eralda (Metahasani) Çani, punim doktore titulluar ‘Këshilli i Ministrave: organ kushtetues e administrativ: analizë politiko-juridike’, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, mars 2008.

se sa materiale. Kjo sepse nga këndvështrimi material duket sikur nuk mbetet shumë për hartuesit e politikave dhe ligjvënësit vendas për sa kohë procesi është thjesht ai i transpozimit të legjislacionit të BE-së. Me të drejtë thuhet që procesi i transpozimit nuk duhet konsideruar si një qëllim në vetvete: edhe vetë BE-ja ligjin e ka një mjet për t'u zhvilluar në mënyrë legjitime, për të mbrojtur interesat e përbashkëta të shteteve dhe qytetarëve.<sup>32</sup> Kështu, ky proces duhet kuptuar, fillimisht përgjatë procesit të stabilizim-asociimit, në nivelin e harmonizimit gjë që do të thotë procesi duhet kuptuar në këndvështrim material po aq sa edhe procedural. Siç u theksua më lart, nuk jemi para një situatë ku harmonizimi ndodh thjesht si një aspekt teknik procedural. Administrata publike shqiptare duhet të reflektojë reforma të thella në vetvete dhe së dyti ajo vetë duhet të përshtatë atë legjislacion që është miratuar apo miratohet duke e parë në këndvështrim krahasues me atë të BE-së dhe duke përfshirë në vendimmarrje të tilla çfarëdo rregullimi ligjor të BE-së. Detyrimi fillimisht është i orientuar në fusha të caktuara, gjë që ndihmon politikëbërësin dhe ligjvënësin shqiptar të orientohet.

### 3.4 Vështirësitë e shfaqura

Në kuadrin e panoramës dhe analizës së paraqitur më lart, mund të përmenden një sërë vështirësish të cilat shpesh shndërrohen edhe në probleme. Kështu, mund të thuhet që administrata shqiptare nuk ka një përvojë apo traditë institucionale që të ndihmojë procesin e integritit. Edhe pse janë ndërmarrë angazhime të ndryshme për të mbështetur rritjen e njohurive institucionale në të drejtën e BE-së në përgjithësi ato kanë reflektuar mangësitë e problematikat e veta. Përgatitja e specialistëve me njohuri të plota e të sakta mbi të drejtën evropiane edhe pse realizohet në shkollat e drejtësisë së pari është e kufizuar, dhe së dyti nuk ofrohet si këndvështrim edhe për shkollat e profesioneve të tjera. Duhet qartësi në dallimin ndërmjet legjislacionit parësor dhe dytësor evropian, dhe pasqyrimi i tij edhe në relacionet dhe tabelat e përputhshmërisë, duke i krahasuar ato sipas rastit me legjislacionin përkatës shqiptar.

Qëndrueshmëria institucionale është një aspekt që ka reflektuar problematikat e veta. Përzgjedhja e njerëzve të aftë si dhe përgatitja e kualifikimi i tyre i vazhdueshëm në këtë drejtim janë më se të domosdoshme për ndjekjen në vijimësi të gjithë këtij procesi. Kjo përzgjedhje jo gjithmonë bëhet duke konsideruar aftësitë e personit të punësuar në administratën publike, madje kjo edhe në rastet e nëpunësve civilë. Më tej, probleme qofshin për shkak të ligjit apo zbatimit të tij, qëndrueshmëria strukturore në institucionet e administratës publike nuk është e pranishme gjithmonë dhe po ashtu as edhe vetë vijueshmëria e marrëdhënieve të punës.<sup>33</sup> Probleme të tilla si p.sh. paqartësi e kuptimit të termit 'nëpunës publik' përdorur në N. 107 dhe atë 'funksionar publik' përdorur në N. 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që passjellin paqartësi për legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës në administratën publike të vendit, apo përdorimi i kontratave të përkohshme në shërbimin civil, apo mungesa e transparencës dhe konkurrueshmërisë në shumë prej pozicioneve të punës jo pjesë e shërbimit civil, etj janë probleme të cilat ende mbeten në legjislacionin shqiptar dhe situatat e zbatimit të tij dhe që ndikojnë në problematikat e qëndrueshmërisë dhe profesionalizimit në administratën publike

<sup>32</sup> *Estonian Ministry of Foreign Affairs: Estonia's way into the European union*, Tallin, 2009.

<sup>33</sup> (Methasani) Çani E., *Marrëdhëniet e Punës në Administratën Publike: Analizë e Legjislacionit Shqiptar*, Qendra AKSES, Shqipëri, Shtëpia Botuese albPaper, Dhjetor 2009.

shqiptare. Kjo situatë në vijimësi ndikon në vetë procesin e integritit për shkak se ky është një proces që kërkon sa qëndrueshmërinë e profesionalizmin si një status i vetë administratës publike, aq edhe profesionalizmin dhe efikasitetin në përafrimin ligjor me legjislacionin e BE-së.

Procesi i përafrimit të legjislacionit kërkon bashkëpunim dhe koordinim më të mirë dhe më integral të mekanizmave të krijuar. Jo vetëm që angazhimi i hallkave të caktuara të administratës së vendit nuk është i reflektuar në të tilla struktura (shih lart), por edhe i shoqërisë civile apo grupeve të interesit në përgjithësi, gjë që passjell mangësi në procesin e analizave të nevojshme.

### 3.5 Interpretimi i legjislacionit në frymën e të drejtës Evropiane

Është më se e nevojshme që edhe legjislacioni shqiptar të interpretohet nën frymën e të drejtës evropiane, kërkesë kjo e kohës dhe domosdoshmëri për shkak të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Dispozitat e saj kanë përparësi mbi të drejtën shqiptare dhe mund dhe duhet të zbatohen drejtpërsëdrejti në realitetin ligjor shqiptar, në referim kjo edhe të nenit 116 apo neneve 121 e 122 të Kushtetutës. Pavarësisht se ende nuk ka jurisprudencë të mjaftueshme nga gjykatat shqiptare në këtë fushë, dispozitat që mund të zbatoheshin drejtpërdrejtë nga gjykatat shqiptare të juridiksionit të zakonshëm janë ndër të tjera nenet 18 dhe 19 (detyrimet doganore drejt Komunitetit dhe drejt Shqipërisë), neni 33 (Pezullimi), neni 34 (ndalimi i diskriminimit fiskal), neni 42 (kufizimet e autorizuar), e tjerë të MSA-së, të cilat për më tepër janë të përcaktuara qartë dhe krijojnë të drejta e detyrime të plota e të sakta për palët.

Është interesant të theksohet në këtë kuadër se Gjykata Kushtetuese e RSH me vendimin e saj Nr. 24, datë 12.05.2009 ka shpallur si në kundërshtim me Kushtetutën Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 52, datë 14.01.2009.<sup>34</sup> Gjykata Kushtetuese theksoi se ky vendim binte në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare dhe konkretisht me nenin 33/2 dhe 42 të MSA. Mendoj se në këtë rast një vendim i tillë mund të ishte marrë drejtpërdrejt nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm, duke zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën komunitare, pra nenet 33/2 dhe 42 të MSA-së. Kjo analizë e ky rast i paraqitur na tregon që një ndër aspektet e rëndësishme që lidhet me transpozimet ka të bëjë me zbatueshmërinë e legjislacionit të BE-së qoftë për shkak të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ashtu edhe për shkak të miratimit të rregullave të brendshme ligjore të harmonizuara me legjislacionin e BE-së. Një aspekt që lidhet me këtë të fundit është edhe interpretimi që gjyqësori shqiptar duhet të bëjë në rastet e konflikteve që shfaqen para tij. Interpretimet dhe jurisprudenca evropiane do të jenë drejtpërdrejt një ndihmë për zgjidhjen e çështjeve në vend. Kjo do të thotë pra njohje e *acquis communautaire*, përfshirë këtu edhe praktikën gjyqësore përkatëse nga sistemi gjyqësor. E gjithë problematika e paraqitur më lart mbi shkallën e duhur të profesionalizimit kështu na vjen e përsëritur edhe për gjyqësorin vendas.

## 4. Përfundime

<sup>34</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave lejonte tregtimin në Shqipëri të naftës D2 vetëm për një shoqëri tregtare. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 24, datë 12.05.2009.

Masat e marra në kuadër të ‘transplanteve’ të nevojshme në kuadër të procesit të integritit janë intensive. Megjithatë, procesi i integritit kërkon reforma të mëtejshme dhe reformat kërkojnë ndër të tjera:

a) vullnet politik të brendshëm.

Mjedisi i brendshëm politik duhet të jetë gati dhe të përshtatë plotësisht kushtet e integritit, duke i konsideruara ato jo si qëllim në vetvete, por si proces që i shërben interesit të vendit dhe qytetarëve.<sup>35</sup> Kjo nuk duhet kuptuar që vetëm konsensusi politik mjafton për bërjen e reformave formale dhe sjelljen e duhur, por kërkohen veprime konkrete tashmë të qarta në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për Shqipërinë.

b) reformim institucional.

Strukturat e krijuara për procesin e integritit janë masa të domosdoshme tashmë të ndërmarra. Modelet e përshtatura kanë qenë të ndryshme, e ai i krijuar për përfaqshjen e legjislacionit në çdo Ministri është pozitiv për shkak të ndarjes së ekspertizën në fusha të posaçme. Një shqetësim që duhet të vendoset edhe në kontekstin e pikës (a) më sipër, është qëndrueshmëria institucionale. Ndryshimet e shpeshta institucionale dëmtojnë procesin e integritit.

c) angazhim profesional në nivel personal jo vetëm të punonjësve të administratës publike.

Punësimi dhe motivimi janë elementë të rëndësishëm që ndikojnë për performancën e vetë administratës publike. Punësimi i personave jo profesionalë dëmton angazhimin dhe motivimin. Në vend janë përshtatur politika të tilla pozitive si ‘Brain Gain’, një shembull ky pozitiv, por që duhet kombinuar me marrjen e masave të tjera për fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve.

---

<sup>35</sup> Anne Hald Petersen- Forvaltning, *EU conditionality - and public administration reform in the Western Balkans*, 2010, <<http://rudar.ruc.dk/bitstream/1800/5406/1/EU%20conditionality%20-%20Anne%20Hald%20Petersen.pdf>>.

## BIBLIOGRAFI

### *Literatura:*

- Anne Hald Petersen- Forvaltning, *EU conditionality - and public administration reform in the Western Balkans*, 2010,
- Eralda (Metahasani) Çani, Punim doktore “Këshilli i Ministrave: organ kushtetues e administrativ: analizë politiko-juridike”, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, mars 2008.
- Estonian Ministry of Foreign Affairs: Estonia’s way into the European union*”, Tallin, 2009.
- (Metahasani) Çani E., *Marrëdhëniet e Punës në Administratën Publike: Analizë e Legjislacionit Shqiptar*, Qendra AKSES, Shqipëri, Shtëpia Botuese albPaper, Dhjetor 2009

### *Burime ligjore dhe vendime gjyqësore:*

- Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr. 9590, datë 27.07.2006 ‘Për Ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtar” SHTOJCA II(B)’
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 557, dt. 5.09.2007.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 580, dt. 10.09.2004 ‘Për krijimin dhe fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integritimit’
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 46, datë 1.04.2009.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 201, dt. 29.03.2006.
- Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 166, datë 16.12.2004.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1017, dt. 18.9.2009, ‘Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të reformës në administratën publike’
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 24, datë 12.05.2009.

### *Raporte:*

- COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES: *ALBANIA 2009 PROGRESS REPORT accompanying the COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL Enlargement Strategy and Main Challenges 2009-2010*, Brussels, 14.10.2009, {COM}, SEC(2009) 1337/3
- Komisioni (BE), ‘A citizens’ agenda – delivering results for Europe’ (Komunikim) COM(2006), 10 maj 2006

### *Burime interneti:*

- <http://www.itap.gov.al/new%20web/PDF%20ITAP/RAPORT%202009%20final-%20ENGLISH.pdf>
- [http://ec.europa.eu/enlargement/albania/key\\_events\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/albania/key_events_en.htm)
- [http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu\\_albania/2009\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2009_progress_report_en.pdf)
- <http://rudar.ruc.dk/bitstream/1800/5406/1/EU%20conditionality%20-%20Anne%20Hald%20Petersen.pdf>